



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.SH.II.nr.987/22**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “S...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.230/19, të datës 25.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 02.02.2023, merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

**HUDHET** poshtë ankesa e paditësit “S...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, si e **pa afatshme**.

### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal A.nr.230/2019, të datës 25.05.2021, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “S...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, në tërësi si e pabazuar dhe ka mbetur në fuqi Aktvendimi 07.3/65/2015 i datës 03.01.2019, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi “S...” Sh.P.K me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore procedurale e materiale dhe konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që të aprovohet ankesa kundër aktgjykimit A.nr.230/19 të datës 25.05.2021 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal.

Dhoma e shkallës së dytë e kësaj gjykate shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 81.H të Ligjit 04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 03/L-222, gjeti se:

**Ankesa është pa afatshme.**

Kolegji i kësaj gjykate me shikimin në fletë kthesë ka vërtetuar se paditësi ka pranuar aktgjykimin A.nr.230/19, të datës 25.05.2021, me datë 15.06.2021, ndërsa ankesën ndaj këtij aktgjykimi e ka dorëzuar në gjykatë me datën 23.08.2023, e cila shihet nga vula e pranimit të Gjykatës, nga data e vendosjes në ankesë si dhe nga akti përcjellës i Gjykatës Themelore në Prishtinë për Gjykatën e Apelit.

Kolegji i kësaj gjykate duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes pasi që në dispozitën e nenit 81.H par.5 të Ligjit 04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 03/L-222 përcaktohet se: *“Vendimi i Gjykatës Themelore mund të kundërshtohet përmes gjykatës kompetente brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve të komunikimit të tij zyrtar tek palët.”*, atëherë rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit prej 60 ditësh, për faktin se afati fillon të llogaritet nga data 16.06.2021, dhe kur llogariten 60 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 16.08.2021. Prandaj, meqë ankesa është paraqitur me datën 23.08.2021, atëherë rezulton se ankesa është paraqitur me vonesë prej 7 ditëve.

Në bazë të të cekurave dhe duke marrë për bazë se afati për ankesë është afat prekluziv, Gjykata e Apelit, në kuptim të dispozitës së nenit 209 par.1, pika (a) të LPK-së, të aplikueshëm në bazë të nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES**  
**Dhoma e Shkallës së Dytë**  
**K.DH.SH.II.nr.987/22, me datë 02.02.2023**

**Kryetar i kolegjit,**  
**Faton Bajrami**